



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Financave dhe Transfereve / Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Financave dhe Transfereve / Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers
Administrata Tatimore e Kosovës / Poreska Administracija Kosovo / Tax Administration of Kosovo

ARKIVA / ARHIVA / ARCHIVE

Mjësia Org. 20
Org. Jedin. 20
Org. unit: 20

Nr. Prot. 02-06-4730
Dr. Prot. 02-06-4730
Prot. No: 02-06-4730

Nr. Faqeve 1
Broj strana 1
No paper: 1

Data 27.12.22
Datum 27.12.22
Date: 27.12.22



Duke u bazuar në rekomandimin e datës 22.12.2022 me nr.protokoli 02-06-4730 të Menaxheres së Projektit/Kontratës dhe Ekipit për menaxhimin e kontratës, pas trajtimit të këtij rekomandimi dhe shkresave të lëndës që kanë të bëjnë me kontratën: “Modernizimi i Sistemit të Teknologjisë Informative sipas kërkesave dhe nevojave të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), me numër të brendshëm prokurimit 1160017012214, me numër eprokurimi 11600174011214” të nënshkruar me datë 15.01.2020, sipas nenit 61(28), nenit 61(29) për Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik të datës 10.01.2016, nenit 41.2.2 (b), (c) dhe (d) të kushteve të përgjithshme të kontratës (më tej: KPK), nenit 12.6.1, 12.6.2 (c) pika 1 dhe 2 të kushteve të veçanta të kontratës (më tej: KVK), nenit 12.6.3 (a) dhe (b) të KPK, nenit 30.4 të KPK, nenit 19.2 të KVK, nenit 19.4 të KPK, nenit 9.3 të KPK, nenit 106, nenit 107, nenit 108, nenit 112, nenit 115 të Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e detyrimeve (i publikuar në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës nr. 16, datë 19 qershor 2012), Menaxheri i Prokurimit pranë Autoritetit Kontraktues – Administrata Tatimore e Kosovës me datë 27 Dhjetor 2022, për zgjidhjen e kësaj kontrate merr këtë:

V E N D I M

I. Ndërpritet dhe përmbillet kontrata përshkak mos realizimit dhe mos përmbushjes të kontratës nga Furnizuesi të kontratës “Modernizimi i Sistemit të Teknologjisë Informative sipas kërkesave dhe nevojave të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), me numër të brendshëm prokurimit 1160017012214, me numër eprokurimi 11600174011214”.

II. Refuzohet kërkesa e datës 15.12.2022 për zgjatjen e kontratës dhe ndryshimin e planit për implementimin e kontratës e parashtruar nga Furnizuesi: “IUNetworks” LLC, Aram Mkhitarian - Drejtor, me adresë: 38/1, Pushkin Str., Building 5, 0010, Yerevan, Republika e Armenisë; “PBC” sh.p.k., Bashkim Selmani - Drejtor, me adresë: Hamdi Mramori, nr.1, Prishtinë; “Mikrobiz” sh.p.k., Naim Berisha - Drejtor, me adresë: Rifat Berisha Rr. E.10, nr.33, Prishtinë; “Tax Accounting Group” sh.p.k., Imer Abdyli - Drejtor, me adresë: Chelsea Point, E4, nr.21, Prishtinë; të përfaqësuar nga lider i konzorciumit i autorizuar nga anëtarët e konzorciumit për këtë kontratë është: “IUNetworks” LLC, (“më tej: Furnizuesi”).

III. Konfiskohet garancioni bankar i ekzekutimit të kontratës në vlerën 1,958,712.20 € i dorëzuar për këtë kontratë nga Furnizuesi.

IV. Furnizuesi e ndërpret të gjithë punën e mëtutjeshme për këtë kontratë. Furnizuesi ka dështuar ti dorëzojë Autoritetit Kontraktues produktin e plotë e të kompletuar ITAMIS sipas kushteve kontratës, për më tepër Furnizuesi ka të dështuar të dorëzojë edhe ndonjë produkt-Modul funksional të pranueshëm që mund të përdoret apo të ketë ndonjë dobi Autoritetit Kontraktues sipas kushteve të kontratës. Nga Autoritetit Kontraktues është vërtetuar se fajësia dhe përgjegjësia për mosrealizimin dhe mospërmbushjen e detyrimit të plotë dhe pjesshëm të kontratës është e Furnizuesit të cilit i ka përfunduar edhe afati shtesë i arsyeshëm i dhënë më vonë pas kontratës nga Autoritetit Kontraktues sipas kërkesës së Furnizuesit i cili as në këtë afat nuk ka përmbush detyrimin e vet.

ARSYETIM

1. Kontrata: “Modernizimi i Sistemit të Teknologjisë Informative sipas kërkesave dhe nevojave të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), me numër të brendshëm prokurimit 1160017012214, nr. eprokurimi: 11600174011214”, mes Autoritetit Kontraktues dhe Furnizuesit është nënshkruar me datë 15.01.2020.
2. Furnizuesi edhe gjatë demonstrimit të produktit të mbajtura në Prishtinë me datat 01, 02.07.2019, po ashtu e ka siguruar Autoritetin Kontraktues se do të plotësojë në tersi kërkesat e dosjes së tenderit, dhe kërkesat e Autoritetit Kontraktues duke dorëzuar produktin funksional dhe operacional në kohë siç është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues.
3. Kontrata ka të bëjë me furnizimin e Sistemit të Teknologjisë Informative sipas kërkesave dhe nevojave të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), e cila përmban, përveç tjerash, planin e zbatimit dhe implementimit të kontratës me të cilin rregullohen afatet për dorëzimin, instalimin, furnizimin deri në pranimin operational të Sistemit të TI-së, në tërësi. Kontratë e cila deri me tani është amendamentuar dy herë: Amendamenti nr. 1 i kontratës është nënshkruar me datë 27.04.2020, dhe Amendamenti nr. 2 i kontratës është nënshkruar me datë 22.07.2021 si rezultat i vonësive të shkaktuara nga Furnizuesi dhe kërkesave të bëra nga Furnizuesi në realizimin e planit të implementimit të projektit me shtyerje të afatit prej 6 muajve nga amendamenti nr.1.
4. Sipas klauzolës 19 të KPK (Klauzola 19 të KVK) Hartimi i Planit të Implementimit të Projektit është obligim i furnizuesit duke u bazuar në kapacitetet e tij ndërsa Autoriteti Kontraktues (më tej: AK) ka kontribuar dhe është perpjekur në eliminimin e mos konformiteteve në plan (nëse ka pasur të tilla) dhe ka aprovuar në tërësi planin siç është prezantuar dhe kërkuar nga furnizuesi.
5. Sipas amendamentit nr. 1 të kontratës (e lidhur përshkak ngjarjeve të forcës madhore me pandeminë e virusit covid), AK dhe Furnizuesi janë dakorduar për ndryshimin e afateve të liferimit të furnizimeve dhe instalimeve të licencave dhe sistemit ITAMIS. Përkundër shtyrjes së afateve me Amendamentimin nr. 1 të kontratës, fazat e testimit dhe funksionalizimit të fazës së parë të projektit, sipas kalendarit të instalimeve dhe planit të implementimit të projektit, nuk u përfunduan brenda afatit nga ana e furnizuesit.
6. Përshkak se nuk u përfunduan brenda afatit nga ana e furnizuesit me amendamentimin nr. 1 të kontratës, Furnizuesi ka paraqitur dhe bërë kërkesën përsëri për shtyerjen e afatit me planin e implementimit të projektit, e cila kërkesë për shtyerje ju është aprovuar nga AK siç është paraqitur dhe kërkuar nga Furnizuesi, për të cilën është lidhur Amendamenti nr.2 i kontratës mes dyja palëve. Sipas amendamentit nr. 2 të kontratës datë 22.07.2021, AK dhe Furnizuesi janë dakorduar për ndryshimin e planit të instalimit dhe pagesave ndaj furnizuesit dhe planin kohor të zbatimit për realizimin e kontratës. Edhe pas Amendamentimit nr. 2 të kontratës, furnizuesi nuk ka arritur që të respektoj afatet e përcaktuara në planin kohor të zbatimit për realizimin e kontratës të përcaktuara në Amendamentimin nr.2, pavarësisht vërejtjeve dhe shqetësimeve që AK i ka drejtuar në mënyrë të vazhdueshme ndaj furnizuesit.
7. Afatet e reja janë paraqitur dhe kërkuar nga vetë Furnizuesi edhe për Amendamentimin nr. 1, edhe për Amendamentimin nr. 2, ku Furnizuesi ka marrë detyrim se do ti respektojë afatet e reja, të cilat afate të reja janë miratuar nga AK. Furnizuesi i është bërë me dije vazhdimisht pas komunikimeve, takimeve të shumta që ka pasur AK me Furnizuesin se afatet e përmbushjes së detyrimeve kontraktuale në kohë janë element thelbësor i përmbushjes së kontratës sipas natyrës së produkteve-moduleve dhe shërbimeve që kërkohet të dorëzohen

në kohë të AK sipas afateve të specifikuara në Amandamentimin nr.2 të kontratës, të cilave afate nuk i është përmbajtur dhe nuk janë respektuar nga Furnizuesi me fajin e tij.

8. Po ashtu Autoriteti Kontraktues gjatë fazës së implementimit të kontratës me kërkesën e furnizuesit për ndërrimin e Menaxheres së Projektit nga ana e Furnizuesit, Autoriteti Kontraktues pas trajtimit të kërkesave dy herë ka aprovuar kërkesën e Furnizuesit për ndërrim të Menaxheres së Projektit duke i dhënë mundësi në realizimin dhe përmbushjen e kontratës nga Furnizuesi. Furnizuesi për këtë kontratë ka pasur të angazhuar tri Menaxhere të Projektit.
9. Në lidhje me aktivitetet e fazës së parë të projektit, Menaxherja e Projektit dhe Ekipi për Menaxhimin e Kontratës kanë përcjellë tek Furnizuesi vërejtje për mos dorëzim të dokumenteve teknike për fazën e parë me datë 11.08.2021, kërkesë për sqarimin e vonësve të shkaktuara dhe shprehjen e shqetësimit në lidhje me mos respektimin e planit kohor të zbatimit në lidhje me fazën e parë me datë 01.09.2021 dhe me datë 16.09.2021. Meqenëse shtrirja / funksionalizimi i fazës së parë të projektit është dashur të dorëzohet në Administratën Tatimore të Kosovës (më tej: ATK) me datë 01.10.2021 dhe Furnizuesi nuk ka arritur në kohë të përfundoj si aktivitet sipas shtojcës 2 planit kohor të zbatimit të kontratës të nënshkruar me amandamentimin nr.2, me datë 20.10.2021 është njoftuar furnizuesi për aplikimin e dëmeve të likuiduara sipas kushteve të kontratës si rezultat i mos respektimit të planit kohor të zbatimit për realizimin e kontratës, respektivisht shtrirjen/funksionalizimin e fazës së parë sipas amandamentimit nr. 2. Po ashtu me datë 20.10.2021 përsëri i është bërë me dije Furnizuesit dhe është kërkuar nga furnizuesi të respektohet plani kohor i zbatimit të realizimit të kontratës sipas amandamentimit nr. 2, duke dorëzuar produktet, shërbimet në gjendje të rregullt sipas kushteve të kontratës.

Me datë 09.11.2021 nga AK është pranuar njoftimi nga furnizuesi i cili thekson rendësin e përmbushjes së duhur dhe në kohë të detyrimeve të pranura dhe siguron AK se nga Furnizuesi prej tani janë marrë të gjitha masat e nevojshme për plotësimin e të gjitha kushteve të fazave tjera të përcaktuara me kontratë dhe shtojcën 2 Programi dhe plani për zbatimin e kontratës sipas amandamentimit nr. 2 të kontratës, ku edhe pasi që siguron AK-në Furnizuesi vazhdon duke mos respektuar planin kohor të zbatimit të kontratës për të dorëzuar shërbimet, produktet në kohë. Në njoftimin e datës 09.11.2021 Furnizuesi kundërshton dëmet e likuiduara të aplikuara nga AK.

AK me datën 26.11.2021 përmes parashtresës i kthen përgjigje dhe e njofton Furnizuesin lidhur me njoftimin e datës 09.11.2021, se nga AK do të aplikohen dëmet e likuiduara në vonesat e shkaktuara nga Furnizuesi për mos dorëzimin e shërbimeve, produkteve në kohë sipas planit kohor të zbatimit të realizimit të kontratës të përcaktuara sipas Amadamentimit nr. 2. AK përsëri në edhe në parashtresën e datës 26.11.2021 ka kërkuar nga furnizuesi të respektohet plani kohor të zbatimit të realizimit të kontratës sipas Amadamentimit nr. 2 duke dorëzuar shërbimet, produktet në kohë dhe të përmbushen obligimet dhe detyrimet e veta nga Furnizuesi sipas kontratës.

10. Në lidhje me aktivitetet e fazës së dytë, Menaxherja e Projektit dhe Ekipi për Menaxhimin e Kontratës kanë përcjellë tek Furnizuesi shqetësimin në lidhje me mos respektimin e planit kohor të zbatimit të kontratës, vonësve të shkaktuara me datë 12.10.2021. Shqetësimet janë shprehur vazhdimisht edhe gjatë prezencës fizike të përfaqësuesit të Furnizuesit në Kosovë nga data 04.11.2021. Meqenëse shtrirja e pjesës së parë të Fazës së dyte të kontratës është dashur të dorëzohet në ATK me datë 02.12.2021 dhe Furnizuesi nuk ka arritur ta përfundoj si aktivitet, me datë 14.12.2021 Furnizuesi është njoftuar për aplikimin e dëmeve të likuiduara si rezultat i mos respektimit të planit kohor të zbatimit për realizimin e kontratës, respektivisht shtrirjen / funksionalizimin e pjesës së parë të fazës së dytë. AK përsëri përmes parashtresës së datës 14.12.2021 ka kërkuar nga furnizuesi të respektoj planin kohor

të zbatimit të realizimit të kontratës sipas amandamentimit nr. 2 duke dorëzuar shërbimet, produktet në kohë dhe të përmbushen obligimet dhe detyrimet kontraktuale nga Furnizuesi sipas kontratës.

Me datë 08.02.2022 nga AK është pranuar njoftimi nga furnizuesi i cili thekson përsëri rendësin e përmbushjes së duhur dhe në kohë të detyrimeve të marra në bazë të kontratës dhe garanton AK se janë marrë të gjitha masat e nevojshme nga Furnizuesi për përmbushjen e kushteve të fazave tjera të parashikuara në kontratë dhe shtojcën 2 planit të implementimit të kontratës sipas amandamentimit nr. 2 të kontratës, ku edhe përsëri pasi që garanton AK-në Furnizuesi vazhdon duke mos respektuar planin kohor të zbatimit të kontratës për të dorëzuar shërbimet, produktet në kohë sipas amandamentimit nr. 2 të kontratës. Në njoftimin e datës 08.02.2022 Furnizuesi kundërshton dëmet e likuiduara të aplikuara nga AK.

Me datë 24.02.2022 përmes parashtresës me shkrim AK ka kundërshtuar njoftimin e datës 08.02.2022 të Furnizuesit, duke njoftuar Furnizuesin se AK qëndron pas parashtresave të datës 20.10.2021, datës 26.11.2021, datës 14.12.2021 të cilat ju janë dërguar Furnizuesit. Po ashtu nga AK në parashtesën e datës 24.02.2022 dërguar Furnizuesit është përsëritur kërkesa për respektimin, zbatimin dhe përmbushjen e detyrimeve kontraktuale nga Furnizuesi sipas kontratës, dhe janë dhënë përsëri arsyet për aplikimin e dëmeve të likuiduara nga AK. Në njoftimin e datës 11.03.2021 Furnizuesi kundërshton dëmet e likuiduara të aplikuara nga AK. Menaxherja e Projektit dhe Ekipi për Menaxhimin e Kontratës në AK në parashtesën e datës 25.03.2022 e njoftojnë Furnizuesin se mbeten prapa qëndrimit në lidhje me aplikimin e dëmeve të likuiduara për vonesat e shkaktuara nga Furnizuesi. Për produktet-modulet, shërbimeve të pa dorëzuara në kohë nga AK janë aplikuar dëmet e likuiduara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës, ku kjo vlerë sipas AK është arritur dhe ka tejkaluar normën mbi 10% të vlerës totale të kontratës për të cilat ka qenë i njoftuar vazhdimisht Furnizuesi, të cilat dëme të likuiduara janë aplikuar si rezultat i vonesave të shkaktuara nga Furnizuesi për mos dorëzimin e produkteve-moduleve, shërbimeve sipas planit për zbatimin e realizimit të kontratës të nënshkruar me amandamentimin nr.2 kontratës.

11. Për mos përmbushjen e detyrimeve kontraktuale, Furnizuesi është njoftuar vazhdimisht nga Autoriteti Kontraktues dhe është kërkuar vazhdimisht respektimi dhe zbatimi i kontratës nga Furnizuesi. Menaxherja e Kontratës dhe Ekipi për Menaxhimin e Kontratës kanë mbajtur dy herë takime virtuale me Furnizuesin ku është rekomandua që nga Furnizuesi të pranohet një raport me arsyetime se perse janë shkaktuar këto vonesa dhe po ashtu është rekomandua që krahas raportit të bëjnë kërkesa për riorganizim të planit kohor të punës dhe afateve kohore të dorëzimit të moduleve në mënyrë që t'i shmangim vonesat e projektit dhe t'i definojnë ma qartë veprimet e palëve si nga ana e Furnizuesit po ashtu edhe nga ana e AK-së. Gjatë takimeve është bërë e qartë për Furnizuesin që kërkesa do të shqyrtohet nga AK e me pas do të veprohet sipas kushteve të kontratës, duke mos levizur datën përfundimtare ta pranimit operacional të ITAMIS. Mirëpo, edhe pse është dakorduar për një gjë të tillë, ne dy takimet me Furnizuesin, Furnizuesi është zotë që do ta bëjë raportin së bashku me kërkesën për riorganizim të afateve, Furnizuesi nuk ka bërë një hap të tillë.
12. Me datë 11.08.2021 nga Menaxherja e Projektit në AK është njoftuar me parashtresë Furnizuesi për mos përmbushje të detyrimeve kontraktuale në kohë sipas planit për zbatimin e kontratës nga Furnizuesi dhe mos përmbushje të kërkesave teknike dhe funksionale sipas kontratës.
13. Me datë 23.09.2021 nga Menaxherja e Projektit në AK është njoftuar me parashtresë Furnizuesi për mos përmbushje të detyrimeve kontraktuale në kohë sipas planit për zbatimin e kontratës nga Furnizuesi.

14. Me datë 26.10.2021 nga Menaxherja e Projektit në AK është njoftuar me parashtresë Furnizuesi për mos përmbushje të detyrimeve kontraktuale në kohë sipas planit për zbatimin e kontratës nga Furnizuesi
15. Me datë 11.10.2021 nga Menaxherja e Projektit në AK është njoftuar me parashtresë Furnizuesi për mos përmbushje të detyrimeve kontraktuale në kohë sipas planit për zbatimin e kontratës nga Furnizuesi.
16. Me datë 12.10.2021 nga Menaxherja e Projektit në AK është njoftuar me parashtresë Furnizuesi me shqetësimet për mos përmbushje të detyrimeve kontraktuale sipas kontratës nga Furnizuesi.
17. Me datë 03.02.2022 nga Menaxherja e Projektit në AK është njoftuar me parashtresë Furnizuesi me shqetësimet për mos përmbushje të detyrimeve kontraktuale në kohë sipas kontratës nga Furnizuesi dhe për vonesat e shkaktuara nga Furnizuesi AK do të veprojë sipas kushteve të kontratës.
18. Me datë 21.02.2022 nga Menaxherja e Projektit në AK është njoftuar me parashtresë Furnizuesi ku janë specifikuar shërbimet, produktet që nuk janë kryer në kohë dhe me shqetësimet për mos përmbushje të detyrimeve kontraktuale sipas kontratës nga Furnizuesi.
19. Me datë 11.03.2022 nga Menaxherja e Projektit në AK është njoftuar me parashtresë Furnizuesi ku janë specifikuar shërbimet, produktet që nuk janë kryer dhe me neglizhimet për mos përmbushje të detyrimeve kontraktuale sipas kontratës nga Furnizuesi.
20. Me datë 08.04.2022 me nr.protokoli 02-06-1671 nga AK i është dorëzuar parashtresa Furnizuesit me vërejtjen e fundit para ndërprerjes së kontratës përshkak mos përmbushjes së detyrimeve dhe obligimeve kontraktuale nga Furnizuesi, duke u bazuar në rekomandimin e datës 21.03.2022 të Menaxheres së Projektit dhe Ekipit për menaxhimin e kontratës, dhe shkresave të lëndës ku janë dhënë arsyetimet, provat, faktet e paraqitura që kanë të bëjnë me mos realizim dhe mos përmbushje të kontratës, ku është kërkuar përsëri nga Furnizuesi të evitohen neglizhencat dhe dështimet të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë për ti përmbushur dhe realizuar obligimet dhe detyrimet e veta që ka Furnizuesi me kontratë duke dorëzuar shërbimet, produktet sipas kontratës dhe planit kohor për zbatimin e realizimit të kontratës sipas amadamentimit nr. 2 të kontratës 22.07.2021.
21. Gjithashtu, me qëllim të pasqyrimin të gjendjes faktike të secilit modul, Menaxherja e Projektit dhe Ekipi për Menaxhimin e Kontrates nga Grupet Punuese në kuader të projektit kanë pranuar raporte të detajuara të cilat përshkruajnë statusin e secilit modul të cilat ju janë dorëzuar Furnizuesit me datën 08.04.2022 me parashtresën – vërejtjen e fundit para ndërprerjes së kontratës, me qëllim Furnizuesit ti jepet kohë në përmissimin, korrigjimin e dështimeve për të dorëzuar modulet dhe shërbimet në gjendje të rregullt funksionale dhe operacionale sipas kontratës. Raportet e dorëzuara furnizuesit me datë 08.04.2022 janë:
 1. Raporti i datës 03.03.2022 për ecurinë dhe progresin për Modulin e “Regjistrimit të Tatimpaguesve”, ku Furnizuesi nuk ka përmbushur shërbimet, produktin për këtë modul sipas obligimeve dhe detyrimeve me kontratë.
 2. Raporti i datës 03.03.2022 për Modulin "Menaxhimi i Komunikimit", ku Furnizuesi nuk ka përmbushur shërbimet, produktin për këtë modul sipas obligimeve dhe detyrimeve me kontratë.
 3. Raporti i datës 03.03.2022 për ecurinë dhe progresin e punës për Modulin “Menaxhimi i Deklaratave Tatimore”, ku Furnizuesi nuk ka përmbushur shërbimet, produktin për këtë modul sipas obligimeve dhe detyrimeve me kontratë.

4. Raporti datës 02.03.2022 për ecurinë dhe progresin e punës për Modulin “Menaxhimi i Pagesave”, ku Furnizuesi nuk ka përmbyllur shërbimet, produktin për këtë modul sipas obligimeve dhe detyrimeve me kontratë.
 5. Raporti i datës 02.03.2022 për ecurinë dhe progresin e punës për Modulin e “Kontabilitetit të të Hyrave”, ku Furnizuesi nuk ka përmbyllur shërbimet, produktin për këtë modul sipas obligimeve dhe detyrimeve me kontratë.
 6. Raporti i datës 02.03.2022 për ecurinë dhe progresin e punës në kuadër për Modulin e “Menaxhimit të Gjithësisë dhe Interesave”, ku Furnizuesi nuk ka dorëzuar asnjë version për këtë modul sipas obligimeve dhe detyrimeve me kontratë.
 7. Raporti i datës 08.03.2022 për ecurinë dhe progresin e punës për Modulin e “Menaxhimit të Rimbursimeve / Kthimeve”, ku Furnizuesi nuk ka përmbyllur shërbimet, produktin për këtë modul sipas obligimeve dhe detyrimeve me kontratë.
 8. Raporti i datës 08.03.2022 për ecurinë dhe progresin e punës për Modulin e “Menaxhimit të Parave të Gjatshme”, ku Furnizuesi nuk ka përmbyllur shërbimet, produktin për këtë modul sipas obligimeve dhe detyrimeve me kontratë.
 9. Raporti i datës 08.03.2022 për ecurinë dhe progresin e punës për Modulin të “E-Faturës”, ku Furnizuesi nuk ka përmbyllur shërbimet, produktin për këtë modul sipas obligimeve dhe detyrimeve me kontratë.
 10. Raporti i datës 08.03.2022 për ecurinë dhe progresin e punës për Modulin të “Menaxhimit të Rrezikut”, ku Furnizuesi nuk ka përmbyllur shërbimet, produktin për këtë modul sipas obligimeve dhe detyrimeve me kontratë.
 11. Raporti i datës 08.03.2022 për ecurinë dhe progresin e punës për Modulin e “Kontrollit dhe Vizitave”, ku Furnizuesi nuk ka përmbyllur shërbimet, produktin për këtë modul sipas obligimeve dhe detyrimeve me kontratë.
 12. Raporti i datës 10.03.2022 për ecurinë dhe progresin e punës për Modulin e “Auditimit / Kontrollit të Brendshëm”, ku Furnizuesi nuk ka përmbyllur shërbimet, produktin për këtë modul sipas obligimeve dhe detyrimeve me kontratë.
 13. Raporti i datës 03.03.2022 për ecurinë dhe progresin e punës për Modulet për “Menaxhimin e shfrytëzuesve”, “Magazina e të Dhënave”, ku Furnizuesi nuk ka përmbyllur shërbimet, produktet për këto module sipas obligimeve dhe detyrimeve me kontratë.
 14. Raport i datës 01.03.2022 për ecurinë dhe progresin e punës për Modulin e “Raportimit dhe analizës”, ku Furnizuesi nuk ka përmbyllur shërbimet, produktin për këtë modul sipas obligimeve dhe detyrimeve me kontratë.
22. Furnizuesi në parashtrësën e datës 11.04.2022 e kundërshton parashtrësën e datës 08.04.2022 të AK-së. Po ashtu në parashtrësën e datës 11.04.2022 Furnizuesi e siguron AK që implementimi do të përfundojë deri në datën përfundimtare të specifikuar në kontratë duke pranuar se ka vonesa në implementim të disa moduleve dhe jo projektit si tërësi. AK me datë 22.04.2022 përmes parashtrësës me shkrim lidhur me parashtrësën e datës 11.04.2022 e njofton Furnizuesin se qëndron pas Parashtrësës – vërejtjen e fundit para ndërprerjes së kontratës përshkak mos përmbylljes së detyrimeve dhe obligimeve kontraktuale nga Furnizuesi, të dërguar Furnizuesit me datën 08.04.2022, ku në parashtrësë janë dhënë arsyetimet, argumentet, faktet, provat e paraqitura në parashtrësë.
23. Furnizuesi me datë 05.09.2022 ka dorëzuar në AK kërkesën për zgjatjen e afatit të kontratës dhe ndryshimin e planit të realizimit të kontratës. Pas trajtimit të kërkesës së furnizuesit AK me datë 19.09.2022 ka njoftuar furnizuesin për refuzimin e kërkesës të datës 05.09.2022 për zgjatjen e afatit të kontratës dhe ndryshimin e planit të implementimit të kontratës, duke u bazuar në parashtrësën e datës 16.09.2022 të Menaxheres së Projektit/Kontratës dhe Ekipit për menaxhimin e kontratës. Duke pasur parasysh koston financiare të deritanishme për këtë projekt sa i përket AK-së, është propozuar që furnizuesi në kuadër të afatit kohor të fundit për dorëzimin e projektit deri me datën 30.11.2022 t'i dorëzojë dhe t'i bëjë të gatshëm për përdorim dhe pranim operacional 4 prej 21 moduleve të cilat është i gatshëm t'i dorëzojë deri

në funksionalizim. Pas datës 30.11.2022 Furnizuesi mund të bëjë kërkesën për zgjatjen e afatit të kontratës dhe ndryshimin e planit të implementimit të kontratës e cila do të trajtohet nga AK dhe pas trajtimit do ti kthehet përgjigje Furnizuesit.

Furnizuesi ka bërë vetë përzgjedhjen e 4 prej 21 moduleve për vendosje në gjendje të rregullt funksionale në serverët e ATK-së, ku sipas vlerësimit të Furnizuesit kanë qenë: 1. Moduli i Regjistrimit të Tatimpaguesve, 2. Moduli i Menaxhimit të Perdoruesve, 3. Moduli i Faturës Elektronike, dhe 4. Moduli i Menaxhimit të Parase së gatshme.

Menaxherja e Projektit me ekipin për menaxhimin e kontratës kanë komunikuar vazhdimisht me Furnizuesin duke i rikujtuar që Proceset Biznesore tashmë të aprovuara të moduleve të perzgjedhura nuk mund të modifikohen, shtohen apo nderrohen në këtë fazë përveç rasteve kur moduli mund të konsiderohet i pa përfunduar apo rasteve të gabimeve teknike.

Gjithashtu Furnizuesi nga Menaxherja e Projektit/Kontratës me datë 08.12.2022 përmes emailit është vënë në dijeni që pasi ta bëjë instalimin 4 moduleve, jo me larg se data 30.11.2022 të njoftoj Menaxheren e Projektit/Kontratës dhe ekipin për menaxhimin e kontratës, sipas klauzolës 26.1 të KPK, që instalimi i 4 moduleve ka ndodhur, atehere Furnizuesi nuk e ka të drejten për ndryshime/modifikime në 4 modulet e vendosura në ambientet e ATK-së deri në përfundim të testimeve dhe raportit nga grupet punuese.

Më datë 30.11.2022, në AK është pranuar njoftimi me shkrim nga Furnizuesi se ka furnizuar dhe instaluar 4 modulet në ambientet e AK-së. Sipas kontratës, afati për trajtimin e moduleve të dorëzuara është 14 ditë nga data e pranimin të njoftimit për instalimin e moduleve. Mirëpo, meqenëse, Furnizuesi nuk ka siguruar me kohe informatat për testim, respektivisht qasjet dhe përdoruesit me qëllim të testimit, testimi ka filluar me vonese, pra me datë 12.12.2022 si shkak i vonesës së Furnizuesit në ofrimin e informatave të nevojshme për testim.

Meqenëse, Grupet punuese gjatë testimit të moduleve kanë vërejtur ndryshime në versione të moduleve të vendosura në ambientet e ATK-së ku në momente të caktuara edhe testimi ka qenë i pamundur dhe se testimet është dashur të ndërpriten si rezultat i ndryshimeve të bëra nga Furnizuesi në versionet e moduleve të vendosura në ambientet e ATK-së, grupi punues VII, ka kërkuar ndërprerjen e qasjes për Furnizuesit në ambientet e ATK-së deri në përfundim të testimeve të moduleve dhe përgatitjes së raportit final. Menaxherja e Projektit me ekipin për menaxhimin e kontratës ka njoftuar Furnizuesin në lidhje me vendimin për ndalimin e qasjes në ambientet e ATK-së, dhe më pas ka bërë ndërprerjen e lidhjes VPN dhe Remote në të gjitha ambientet e brendshme të ATK-së (ambientet testuese të dedikuara për projekt).

Gjithashtu, me qëllim të pasqyrit të saktë të gjendjes faktike të secilit modul, Menaxherja e Projektit/Kontratës me ekipin e menaxhimit të kontratës me datë 21.12.2022 përmes menaxheres së implementimit të projektit kanë pranuar raporte të detajuara nga grupet punuese në kuadër të projektit, të cilat pershkruajne statusin e secilit modul deri me tani. Duke u bazuar në raportet finale të grupeve punuese me të cilat vertetohet dhe konstatohet se Furnizuesi nuk ka arrit të përmbushë as pjesërisht kontratën (dorëzimin dhe instalimin e 4 moduleve të gatshme për pranimin operacional deri me datë 30.11.2022) sipas kërkesave dhe nevojave të ATK-së, të percaktuara në kontratë, dhe si rrjedhojë plani i implementimit të kontratës ka arritur në afatin e fundit duke mbetur si plan i skaduar, pa produkt, dhe as nuk është dorëzuar dhe pranuar ndonjë modul funksional.

24. Kërkesa e Furnizuesit e datës 15.12.2022 për zgjatjen e kontratës dhe afatit për planin e implementimit të projektit, pas trajtimit që është bërë nga Autoritetit Kontraktues është vlerësuar e paqëndrueshme dhe refuzohet nga AK kërkesa për zgjatjen e kontratës dhe planit për implementimin e kontratës. Furnizuesi gjatë demonstrimit të produktit të mbajtur në Prishtinë e datat 01, 02.07.2019 e ka siguruar AK se ka produkt, dhe do ti modifikoj,

zhvillojë, funksionalizoj e do të bëjë operativ produktin me ndryshimet në Module sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktues, ndërsa tani në implementim të kontratës kur nuk mund të funksionalizojë dhe ti bëjë operacionale produktin, modulet për shfrytëzim për përdoruesin e fundit, mundohet të gjejë arsye të kërkesa për modulën faturës elektronike, për modulën e parasë së gatshme, e të cilat nuk qëndrojnë por janë si arsye nga furnizuesi i cili ka dështuar të përmbush dhe realizoj detyrimet e tij me kontratë, ku nga Menaxherja e Projektit, grupet punuese ka pasur përgjigje në kohë për modulën e faturës elektronike, modulën e parasë së gatshme sipas kërkesave që janë paraqitur, por defekti ka qëndruar se Furnizuesi ka dështuar në përmbushjen e kërkesave teknike për funksionalizim edhe të modulit të faturës elektronike, dhe modulit të parasë së gatshme të cilat janë konstatuar nga AK dhe Furnizuesi ka qenë i njoftuar vazhdimisht për mospërmbushje të kërkesave edhe për këto dy module.

Lidhur me kërkesën tjetër për përkthim të dokumenteve në gjuhën Shqipe, edhe kjo kërkesë nuk qëndron sepse përkthimin në gjuhën Shqipe të dokumenteve e ka ditur Furnizuesi që nga koha kur është publikuar aktiviteti, e jo të ngritet si arsye vetëm për të mos arsyetuar mos përmbushjen e kontratës. Kjo ka ndodhur me fajësinë e Furnizuesi sepse ka pasur raste madje deri 9 herë kur ka ndryshuar versionet e dokumenteve përshkak se Furnizuesi i ka përgaditur dokumentet me defekte, të cilat nuk janë përgaditur sipas kërkesave të Menaxheres së Projektit dhe grupeve punuese në AK, për të cilat vazhdimisht ka qenë i njoftuar Furnizuesi.

Kërkesa tjetër për kohëzgjatjen e testimit, nuk qëndron sepse nga Menaxherja e Projektit dhe grupet punuese testimet janë bërë në kohë dhe përgjigjet për testimet i ka marrë me kohë Furnizuesi, por defekti ka qenë se Furnizuesi nuk i ka përgaditur dhe dorëzuar Modulet të rregullta dhe të pranueshme për testim sipas kërkesave të Menaxheres së Projektit dhe grupeve punuese, madje duke i ndryshuar version pas versionit, dhe nuk janë dorëzuar sipas kontratës.

Lidhur me arsyen tjetër për covid 19 dhe lufta në Armeni, edhe kjo arsye nuk qëndron për faktin se Autoriteti Kontraktues i ka pasur parasysh këtë dhe ka bërë amendamentimet e kontratës, të cilat kanë ndodhur me kërkesën e Furnizuesit dhe amendamentimet e bëra janë bërë sipas kërkesës së Furnizuesit, por tani Furnizuesi e përdorë si arsye përshkak dështimit në mospërmbushje dhe realizim të kontratës.

Sa i përket kërkesës tjetër për grupet punuese, edhe kjo arsye nuk qëndron për faktin se Furnizuesi ka dështuar në përmbushjen e kontratës, dhe tani mundohet si arsye të gjejë te grupet punuese për të cilën çështje nuk e ka ngritur më herët nga nënshkrimi i kontratës, por e ngrit në fund të implementimit të projektit kur dështon në dorëzimin dhe mosrealizimin projektit.

25. Nga Menaxherja e Projektit/Kontratës me ekipin për menaxhimin e kontratës, Menaxherja për implementimin e projektit, grupet punuese është treguar përkushtim gjatë gjithë kohës se implementimit të kontratës, në drejtim të shtyrjes përpara të projektit, duke aplikuar kështu një qasje proaktive në avancimin e mëtutjeshëm të proceseve, përmes dhënies së kontributit aq të çmueshëm në formë të ndryshme, qoftë përmes takimeve fizike, virtuale, kontakteve, kërkesave, komenteve etj. për të identifikuar dhe adresuar çështje të ndryshme në përmirësimin e vazhdueshëm të procesit me qëllim të shtyrjes përpara të projektit.
26. Menaxherja e Projektit dhe Ekipi për menaxhimin e kontratës duke bazuar në raportet e Grupeve Punuese, në gjendjen e konstatuar me raportet e Grupeve Punuese me të cilat raporte konstatohet se Furnizuesi nuk i ka përmbush detyrimet e kontratës si të plotë, as pjesëshme, duke mos dorëzuar produktin e plotë, dhe duke mos dorëzuar ndonjë Modul, sipas kontratës dhe sipas planit për zbatimin e realizimit të kontratës sipas amendamentimit nr. 2 të kontratës të datës 22.07.2021, përkundër asaj se dy herë ju kanë zgjat afatet Furnizuesit duke vendosur afate të reja sipas kërkesës së Furnizuesit, për të cilat edhe përkundër se Furnizuesi ka siguruar AK-në se do ti respektojë, nuk i ka respektuar edhe me zgjatjen e afateve dhe vendosjen e afatave të reja edhe pse afatet janë vendosur nga vetë

Furnizuesi. Furnizuesi ka qenë i njoftuar vazhdimisht se për Autoritetin Kontraktues afatet e përmbushjes së detyrimeve kontraktuale në kohë janë element thelbësor i përmbushjes së kontratës sipas natyrës së produkteve funksionale që kërkohet të dorëzohen në kohë sipas afateve të specifikuara në amandamentimin nr.2 të kontratës.

Për mospërmbushjen e detyrimeve kontraktuale furnizuesi është njoftuar vazhdimisht nga Autoriteti Kontraktues, dhe nga Furnizuesi është kërkuar vazhdimisht të respektohen detyrimet kontraktuale dhe përmbushja e kontratës sipas kushteve të kontratës, dhe afateve të specifikuara në amandamentimin nr. 2 të kontratës në planin e zbatimit të realizimit të kontratës.

27. Meqenëse me datë 16.12.2022 ka qenë afati i fundit i planit të implementimit të kontratës, konkretisht Komisionimi - Testimi dhe Pranimi Operativ i ITAMIS, për këtë Furnizuesit i është dhënë afat i arsyeshëm nga data 08.04.2022 ku është njoftuar me vërejtjen e fundit para ndërprerjes së kontratës, me qëllim për ti përmissuar, korrigjuar, defektet, neglizhencën dhe dështimet të cilat kanë ndikuar në realizimin e kontratës nga ana e Furnizuesit. Ky afat i arsyeshëm i dhënë për tu përmissuar Furnizuesi në detyrimet e tij ndaj kontratës, dhe dy amandamentimet e kontratës përfshirë shtyerjen e afatit të ri të arsyeshëm të dhënë sipas kërkesës së paraqitur nga Furnizuesi për realizimin e kontratës, krejt këto kanë qenë veprime të Autoritetit Kontraktues për të shmangur ndërprerjen e kontratës.
28. Me zgjidhjen e kontratës përshkak mosrealizimit dhe mos përmbushjes të detyrimeve të përcaktuara me kontratë për të cilën fajësia është e Furnizuesit, Autoriteti Kontraktues do të vazhdojë me veprimet ligjore për shpërblimin e dëmit dhe veprime tjera sipas rregullave ligjore të aplikueshme, me pasoja juridike të cilat janë shkaktuar me fajësinë e Furnizuesit.
29. Andaj si përfundim Autoriteti Kontraktues duke marrë parasysh faktet, argumentet, provat e lartshënuara, edhe përkundër vullnetit të Autoritetit Kontraktues për realizimin e suksesshëm të kësaj kontrate, Autoriteti Kontraktues është i obliguar të veprojë sipas nenit 41.2.2 (b), (c) dhe (d) të kushteve të përgjithshme të kontratës (KPK), nenit 12.6.1, 12.6.2 (c) pika 1 dhe 2 të kushteve të veçanta të kontratës (KVK), nenit 12.6.3 (a) dhe (b) të KPK, nenit 30.4 të KPK, nenit 19.2 të KVK, nenit 19.4 të KPK, nenit 9.3 të KPK, nenit 61(28), nenit 61(29) për Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik të datës 10.01.2016 nenit 106, nenit 107, nenit 108, nenit 112, nenit 115 të Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e detyrimeve (i publikuar në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës nr. 16, datë 19 qershor 2012), për zgjidhjen e kontratës duke ndërprerë kontratën për shkak mos realizimit dhe mos përmbushjes të detyrimeve të kontratës me fajësinë e Furnizuesit për kontratën "Modernizimi i Sistemit të Teknologjisë Informative sipas kërkesave dhe nevojave të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), me numër të brendshëm prokurimit 1160017012214, nr. eprokurimi: 11600174011214" të nënshkruar me datë 15.01.2020, amandamentimit nr. 2 të kontratës të nënshkruar me datë 22.07.2021.
30. Duke marrë parasysh faktet, argumentet, provat e lartshënuara, dhe në atë që u tha më lartë, Autoriteti Kontraktues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Menaxheri i Prokurimit pranë AK-së
Azem Duraku



Vendimi për ndërprerjen dhe përmbylljen e kontratës i dërgohet Furnizuesit sipas nenit 4.1, 4.2 të kushteve të veçanta të kontratës, nenit 6 të marrëveshjes së kontratës.

Shtojcë: Të bashkangjitur me vendimin për ndërprerjen dhe përmbylljen e kontratës keni:

- Raporti për Modulin e “Regjistrimit të Tatimpaguesve”,
- Raporti për Modulin e “Menaxhimit të Parave të Gatshme”,
- Raporti për Modulin e “E-faturës”,
- Raporti për Modulin e “Menaxhimit të shfrytëzuesve”,

Vendimi për ndërprerjen dhe përmbylljen e kontratës i dërgohet:

- “IUNetworks” LLC, Aram Mkhitaryan - Drejtor, me adresë: 38/1, Pushkin Str., Building 5, 0010, Yerevan, Republika e Armenisë; "PBC" sh.p.k., Bashkim Selmani - Drejtor, me adresë: Hamdi Mramori, nr.1, Prishtinë; "Mikrobiz" sh.p.k., Naim Berisha - Drejtor, me adresë: Rifat Berisha Rr. E.10, nr.33, Prishtinë; "Tax Accounting Group" sh.p.k., Imer Abdyli - Drejtor, me adresë: Chelsea Point, E4, nr.21, Prishtinë.
- Menaxheres së Projektit të caktuar nga furnizuesi,
- Menaxheres së Projektit dhe Ekipit për Menaxhimin e Kontratës në ATK,
- Komitetit Drejtues të themeluar për këtë projekt në ATK,
- Zyrtarit Kryesor Administrativ në ATK,
- Zyrtarit Autorizues në ATK.